

VENDIM
Nr. 185, datë 7.8.2025

MBI SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 101, DATË 7.11.2014, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘UKKO’ SHA, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA IMPIANTE FOTOVOLTAIKE ME FUQI 1 MW”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.8.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2257 prot., datë 1.8.2025, të drejtorive teknike të ERE-s, “Mbi licencën për prodhimin e energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Ujësjiellës-Kanalizime Korçë’ sh.a., me vendimin e Bordit nr. 101, datë 7.11.2014”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Ujësjiellës-Kanalizime Korçë” sh.a. është licencuar me vendimin e Bordit nr. 101, datë 7.11.2014, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 1 mw, për një afat 30-vjeçar dhe është mbajtëse e licencës nr. 249, seria PVF14.

- Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112, datë 23.5.2025, “Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2025”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 105, datë 17.6.2025, janë përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2025, për subjektet e licencuara në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Gjatë dërgimit të faturave të fiskalizuara, për çdo subjekt është konstatuar se NIPT-i i shoqërisë “Ujësjiellës-Kanalizime Korçë” sh.a., ishte i panjohur te të dhënat e tatimpaguesve.

- Sa konstatuar nga ekstrakti historik i regjistrit tregtar të shoqërisë, aksesuar nga faqja *online* e Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), rezulton se aktualisht shoqëria “Ujësjiellës-Kanalizime Korçë” sh.a., me NIPT J64103141O, ka statusin “çregjistruar”, nuk ekziston më si person juridik apo subjekt tregtar dhe veprimtaria e saj është transferuar te një subjekt tjetër: “Shoqëria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Korçë” sh.a.

- Në referencë të sa parashikuar në pikën 6.2 të kushteve të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, rezulton se shoqëria “Ujësjiellës-Kanalizime Korçë” sh.a., ka transferuar të gjithë veprimtarinë ekonomike të saj pa marrë miratimin e ERE-s.

- Në lidhje me vijimin e veprimtarisë së centralit fotovoltaiik, në nenin 37, pika 6, germa “b”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe në nenin 4, pika 3, germa “b”, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, përcaktohet, se: “Nuk janë të detyruar të pajisen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike prodhuesit, përfshirë edhe vetëprodhuesit, e lidhur me rrjetin kombëtar, me kapacitet të instaluar deri në 1 mw.

- Për sa kohë rezulton e provuar se licenca për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Ujësjiellës-Kanalizime Korçë” sh.a., përbën një akt administrativ të nxjerrë nga organi kompetent dhe në zbatim të procedurave përkatëse ligjore, si dhe është ushtruar në mënyrë të ligjshme deri në momentin e marrjes në dijeni të rrethanave të transferimit të veprimtarisë ekonomike të shoqërisë, vlerësohet se jemi në rrethanat e parashikuara nga neni 113 i KPA-së, për shfuqizimin e vendimit nr. 101/2014, me anë të të cilit është miratuar dhënia e licencës shoqërisë “Ujësjiellës-Kanalizime Korçë” sh.a. - Me shfuqizimin e aktit, pushojnë ose humbasin pasojat e tij juridike dhe në rastin konkret, me shfuqizimin e vendimit të Bordit nr. 101/2014,

licenca për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike humbet vlefshmërinë e saj, duke filluar nga hyrja në fuqi e këtij shfuqizimi dhe në vijim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë vendimin e Bordit të ERE-s nr. 101, datë 7.11.2014, për licencimin e shoqërisë “Ujësjetës*Kanalizime Korçë” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 1 mw.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e miratuar me vendimin nr. 101, datë 7.11.2014, bëhet e pavlefshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti